

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES PËR BASHKËPUNIMIN, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE EUROJUST-IT”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektligji synon ratifikimin e marrëveshjes së bashkëpunimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Eurojust-it. Kjo marrëveshje ka si qëllim përmirësimin e bashkëpunimit gjyqësor, si dhe lehtësimin e bashkërendimit të hetimeve e të ndjekjeve penale, që shtrihen në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe një ose më shumë shteteve anëtare të Bashkimit Evropian.

Objektivat kryesorë të këtij akti janë, si më poshtë:

- a) Fuqizimi i bashkëpunimit në luftën kundër krimeve të rënda, veçanërisht krimit të organizuar dhe terrorizmit;
- b) Bashkërendimi dhe financimi i veprimeve hetimore të përbashkëta, njëkohësisht me financim të BE-së, nëpërmjet skuadrave hetimore të përbashkëta;
- c) Garantimi i një niveli mbrojtjeje për të dhënat personale të ofruara nga pala tjetër, në respektim të Konventës së Këshillit të Evropës, të 28 janarit 1981, “Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale”, dhe të parimeve të përcaktuara në vendimin e Eurojust-it.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ratifikimi i marrëveshjes është në përputhje me politikat e qeverisë shqiptare, për t’u angazhuar intensivisht dhe në mënyrë të qëndrueshme për goditjen e krimit të organizuar dhe trafikut të qenieve njerëzore e substancave narkotike, në respekt të plotë të ligjeve të vendit dhe të angazhimeve të saj ndërkombëtare.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Gjatë viteve të fundit, Shqipëria ka bërë progres në luftën kundër krimit të organizuar, trafikimit dhe terrorizmit. Strategjia Ndërsektoriale e Luftës kundër Krimit të Organizuar, Trafikimit dhe Terrorizmit, 2014-2020, u përditësua në nëntor të vitit 2014 dhe përfshin luftën kundër trafikimit të fëmijëve, luftën kundër pastrimit të parave dhe luftën kundër trafikimit të lëndëve narkotike.

Gjithashtu, plani i veprimit i posaçëm i Strategjisë së Luftës kundër Trafikimit të Njerëzve u përgatit dhe miratua në të njëjtin vit.

Aktualisht, pavarësisht mungesës së një marrëveshjeje, Republika e Shqipërisë ka pasur komunikim me Eurojust-in, në kuadër të disa çështjeve të përbashkëta hetimore në bashkëpunim edhe me përfaqësuesit e Prokurorisë, në cilësinë e palës së tretë, në mbështetje të një skuadre hetimore të përbashkët, si dhe ka asistuar në ekzekutimin e letërporosive, si pjesë të hetimeve ndërkombëtare.

Megjithatë, pavarësisht përpjekjeve dhe progresit të bërë në luftën kundër krimit të organizuar, trafikimit dhe terrorizmit, ende ka mjaft problematika që vërehen në sistemin gjyqësor, të tilla si: mungesa e bashkëpunimit midis agjencive të zbatimit të ligjit, ekzistenca e vështirësive në krijimin e të dhënave të gjurmueshme, të besueshme, të hetimeve parandaluese, të proceseve dhe dënimeve të shoqëruara me përdorimin sistematik të hetimeve financiare, mungesa e koordinimit ndaj luftës kundër prodhimit dhe trafikimit të drogave etj.

Për pasojë, lind domosdoshmëria e intensifikimit të masave të ndërmarra nga ana e shtetit shqiptar, në kuadër të përmirësimit të klimës në drejtësi.

Në këto kushte, lidhja e një marrëveshjeje me Eurojust-in, do të nxisë bashkërendimin real mes hetimeve ekzistuese në më shumë se një vend anëtar, nëpërmjet shkëmbimit të menjëhershëm të akteve, dokumenteve dhe informacioneve.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji i propozuar është në përputhje me Kushtetutën, si dhe parashikimet e kërkuara nga ligji nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Projektligji nuk synon përafrimin me *acquis* të BE-së, por nënshkrimi i një marrëveshjeje me Eurojust-in konsolidon pikëpamjen që lufta kundër krimit të organizuar, duke qenë një objektiv parësor i Bashkimit Evropian, duhet të udhëhiqet nga hetime të përbashkëta mes vendeve anëtare, duke u trajtuar në një këndvështrim komunitar.

Bashkimi Evropian, si një organizatë shumë e rëndësishme e karakterit ndërkombëtar, konsiston në adoptimin e standardeve evropiane dhe në mbrojtjen e vlerave në legjislacionet nacionale, gjë e cila mund të konsiderohet si proces i evropianizimit. Ndër prioritetet e këtij procesi përfshihet edhe mbrojtja e njëjtë e lirive dhe e të drejtave individuale në fushën e së drejtës

penale, pa marrë parasysh se në cilin shtet gjendet personi. Po ashtu, ky mekanizëm ndërkombëtar me anë të shumë konventave dhe marrëveshjeve ka ndihmuar për avancimin dhe harmonizimin e legjislacioneve penale nacionale.

Në këtë aspekt, Eurojust (Sistemi Evropian i Njësisë Ligjore), i krijuar si një strukturë e BE-së, luan një rol qendror në ekipet e përbashkëta hetimore, përkatësisht në Ballkanin Perëndimor dhe në BE.

Në këtë kontekst, bashkëpunimi gjyqësor është i rëndësishëm për ndërtimin e besimit të ndërsjellë ndërmjet autoriteteve gjyqësore të shteteve anëtare dhe trajnimi gjyqësor duhet të shihet si një element thelbësor në promovimin e një kulture të mirëfilltë gjyqësore dhe ligjore evropiane. Për këtë arsye, hartimi i projektligjit mbështetet në faktin e aspirimit të shtetit shqiptar për të qenë anëtar i BE-së. Gjithashtu, marrëveshja me Eurojust-in do të kontribuojë në realizimin e pesë prioritetëve të vendosura nga Komisioni Evropian ndaj Republikës së Shqipërisë, veçanërisht në kuadër të prioritetit të katërt “Lufta kundër krimit të organizuar”.

Sa më sipër, përfshihet edhe në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020, e cila, ndër të tjera, synon zbatimin e marrëveshjeve ekzistuese dhe formave të reja të bashkëpunimit të policisë, me vendet e rajonit dhe të BE-së.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Eurojust është një strukturë e BE-së e bashkëpunimit gjyqësor, me qendër në Hagë, e krijuar në bazë të vendimit të Këshillit të Evropës të datës 28 shkurt 2002, i amenduar me vendimin e Këshillit të 2009/426/JHA, të datës 17.12.2008, e përbërë nga prokurorë kombëtarë, magjistratë ose oficerë gjyqësorë ekuivalentë, sipas legjislacionit të secilit shtet anëtar, dhe që synon forcimin e hetimeve dhe luftës kundër krimit të organizuar ndërkombëtar.

Duke qenë një organizëm gjyqësor evropian që bashkërendon të gjitha hetimet kundër formave të rënda të krimit të organizuar, kjo agjenci mund t’u japë shtysë hetimeve dhe mund t’u kërkojë autoriteteve të shteteve palë të marrëveshjes të vlerësojnë mundësinë e krijimit të skuadrave hetimore të përbashkëta dhe të sigurojnë informacione të ndërsjella mes autoriteteve të përfshira në rastet e veçanta.

Në shtator të vitit 2010, shteti shqiptar ka filluar bisedimet në nivel teknik për të analizuar mundësitë e arritjes së nënshkrimit të marrëveshjes me Eurojust. Kjo është një marrëveshje tip, nënshkrimi i së cilës kërkon përmbytjen e kushteve dhe të standardeve të përcaktuara në lidhje me përpunimin dhe mbrojtjen e të dhënave personale, në përputhje me Konventën e Këshillit të Evropës nr.108, të 28 janarit 1981, “Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale”, si dhe protokollin shtesë të saj.

Z. Ladislav Hamaran, Zëvendëspresident i Eurojust-it, nëpërmjet shkresës me nr.314 prot., datë 16.1.2017, drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, ka ftuar Republikën e Shqipërisë të fillojë procedurat e negociimit për nënshkrimin e marrëveshjes me Eurojust-in.

Në vijim të kërkesës të Ministrisë së Drejtësisë drejtuar institucioneve respektive, si dhe kthimit të përgjigjeve nga këto të fundit, nëpërmjet shkresave me nr.101/1 prot., datë 23.1.2017 (Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale) dhe nr.194/1 prot., datë 24.1.2017 (Prokuroria e Përgjithshme), Ministria e Drejtësisë ka kërkuar lëshimin e autorizimit ndaj Ministrisë së Punëve të Jashtme, për ngritjen e grupit negociues, duke propozuar edhe anëtarët përkatës të grupit të negociimit.

Ndërkohë që, paralelisht, nëpërmjet shkresës me nr.314/7 prot., datë 30.3.2017, të Ministrisë së Drejtësisë, është përcjellë për mendim teksti paraprak i marrëveshjes, me qëllim dhënien e orientimeve të mundshme ndaj grupit negociues mbi qëndrimin e shtetit shqiptar për çështjen në fjalë.

Mbështetur në qëndrimet përkatëse të institucioneve të interesuara nga zbatimi i marrëveshjes respektive, si dhe në plotfuqinë e lëshuar nga Ministria e Punëve të Jashtme nëpërmjet shkresës me nr.4582 prot., datë 6.4.2017, në datën 11.5.2017 janë zhvilluar në Hagë, në ambientet e Eurojust-it, bisedimet ndërmjet delegacionit të Eurojust-it dhe atij të Republikës së Shqipërisë, për arritjen e një drafti të pranueshëm nga palët, sipas modelit të marrëveshjes së propozuar nga Eurojust, duke bërë, sipas rastit, edhe ndryshimet e nevojshme për të pasqyruar kërkesat e legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Gjatë negociimit, palët pjesëmarrëse kanë shprehur dakordësinë e tyre për të gjitha nenet e marrëveshjes së bashkëpunimit dhe takimi u përmbyll me nënshkrimin e marrëveshjes së negociuar nga krerët e të dyja delegacioneve.

Me vendimin nr.290, datë 21.5.2018, të Këshillit të Ministrave, është miratuar në parim, marrëveshja e bashkëpunimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Eurojust-it.

Ndërkohë që, bazuar në nenin 17, të ligjit nr.43/2016, Ministria e Drejtësisë ngarkohet me detyrimin e hartimit dhe përcjelljes për mendim të projektligjit që synon ratifikimin e marrëveshjes në fjalë.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Prokuroria e Përgjithshme është institucioni shqiptar që ngarkohet me zbatimin e marrëveshjes.

Për të lehtësuar bashkëpunimin e parashikuar në këtë marrëveshje dhe në mbështetje me dispozitat e nenit 27 (3) të vendimit për Eurojust-in, shteti palë i kësaj marrëveshjeje cakton një prokuror si pikë kontakti. Prokurori ndërlidhës i nënshtrohet ligjit shqiptar, në lidhje me statusin e tij, mandatin, kompetencat dhe kohëzgjatjen e komandimit.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Marrëveshja është hartuar nga Eurojust-i dhe është përkthyer e certifikuar nga Ministria e Drejtësisë.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Marrëveshja me Eurojust-in mundëson financimin e veprimeve hetimore të përbashkëta në disa shtete njëkohësisht me financim të BE-së, nëpërmjet strukturave hetimore të përbashkëta.

Nëse nga ekzekutimi i kësaj marrëveshjeje lindin shpenzime të një natyre të jashtëzakonshme, palët mund të konsultohen me synim përcaktimin e mënyrës në të cilën duhet të trajtohen, si dhe këto shpenzime do të përballohen brenda tavaneve të miratuara për institucionet që janë palë e kësaj marrëveshjeje.

KËSHILLI I MINISTRAVE